

# AKTI I THEMELIMIT

## NDERMJET:

1. Shoqeria Anonime "ALUMIL-MYLONAS, ALUMINIUM EXTRUSION INDUSTRY A.E." me seli ne Zona Industriale Stavrohorio Kilkis - Greqi e perfaqesuar nga Z.Georgios Mylonas.
  2. Georgios MYLONAS, i biri i Aleksandrit, lindur ne vitin 1959 ne Dhomiros Seron - Greqi, me numer M - 986704 te pasaportes greke dhe banues ne Rr. Pythagora Nr.23, Panorama - Selanik, Greqi;
  3. Evangelia MYLONA, e bija e Aleksandrit e lindur ne vitin 1964 ne Serres - Greqi, me numer te pasaportes greke M - 179605 dhe banuese ne Rr. Vryoylon Nr.1, Kallamaria, Selanik-Greqi;
  4. Panajot KALLUDHI, i biri i Nikolles, i datelindjes 1956, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, Rruga Budi Nr. 43 me Nr. pasaporte 0250328.
- Te katert pjesemarresit rane dakord qe te krijojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "ALUMIL-ALBANIA" SHPK. Tirane.

## NENI 1

Objekti i veprimtarise te kesaj shoqerie do te jete:

- Tregeti e pergjithshme Import-Eksport.
- Ndertimi i nje Fabrike Alumini, importim, prodhim dhe tregtim i profileve te aluminit, aksesoreve te aluminit, shkrije, derdhje alumini, lyerje profilesh alumini.
- Import-Eksport dhe tregtim skrap i aluminit.
- Import-Eksport dhe tregtim i cdo materiali ndertimi si dhe malli me kete prejardhje dhe kryerja e sherbimeve.
- Shoqeria gjithashtu ne veprimtarine e saj kryesore dhe ndihmese do te kryeje dhe aktivitete te tjera qe lidhen me objektin kryesor te veprimtarise se shoqerise dhe qe duhet te jete ne perputhshmeri me interesat e saj.

Objekti dhe veprimtaria e kesaj shoqerije tregtare si dhe marrdheniet e saj me personat fizike e juridike shqiptare e te huaj, percaktohen ne Statutin e saj dhe rregullohen nga legjislacioni perkates ne Republiken e Shqiperise.

## NENI 2

Kapitali i themeltar i Shoqerise caktohet ne 120.000 (njqind e njezet mije) Dollar USA. Kapitali i mesiperm ndahet ne dyqint pjese, me vlere 600 Dollar USA secila.

Konkretisht Kapitali themeltar i depozituar nga ortaket themelues eshte i ndare:

- Shoqeria Anonime "ALUMIL-MYLONAS, ALUMINIUM EXTRUSION INDUSTRY A.E." ne Kilkis-Greqi ne shumen 112.800 DollarUSA, me 188 pjese te kapitalit themeltar, baraz me 94 %.
- Georgios Mylonas me shumen 2.400 DollarUSA, me 4 pjese, baraz me 2% te kapitalit themeltar.
- Evangelia Mylona me shumen 2.400 DollarUSA, me 4 pjese, baraz me 2% te kapitalit themeltar.
- Panajot Kalludhi me shumen 2.400 Dollar USA, me 4 pjese, baraz me 2% te kapitalit themeltar.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar permes shtimit te pjeseve te reja, ortaket kane te drejten e perparise me nenshkrimin, proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre, por ata jane te lire te heqin dore nga kjo e drejte.

### NENI 3

Kapitali baze i shoqerise tregtare te lartpermendur, sipas nenit 2 te ketij akti, perfaqeson mjetet themelore te xhiros etj., te nevojshme per veprimtarine ekonomike private te saj.

### NENI 4

Ne librin e llogarise se shoqerise tregtare shenohen fondi themelor i paleve kontraktuese, kapitalet e vena nga secila pale kontraktuese ne baze te nenit 2 te ketij akti.

### NENI 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete e pacaktuar.

### NENI 6

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ALUMIL-ALBANIA" SH.P.K., Tirane, e fillon aktivitetin e saj me kete emertim menjehere pas regjistrimit te saj ne librin tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

### NENI 7

Shoqeria e lartpermendur pergjigjet per detyrimet e veta me fondet e veta.

### NENI 8

Te drejtat e paleve kontraktuese jane:

- Te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise;
- te marrin pjese ne ndarjen e fitimit te kesaj shoqerie tregtare ne perputheje me statutin;
- te marrin pjesen e patundshme te shoqerise me pushimin e veprimtarise se saj.

### NENI 9

Detyrimet e paleve kontraktuese jane:

- te vene ne kapitalin baze te shoqerise pjesen perkatese te tyre sipas nenit 2 te ketij akti,
- te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise sipas statutit;
- te ruajne sekretin e shoqerise tregtare;
- te veprojne me inisiativete per realizimin me sukses te objektit te shoqerise tregtare.

### NENI 10

Palet kontraktuese rane dakort qe ndarja e fitimeve te realizuara nga aktivitetet e kesaj shoqerije tregtare me pergjegjesi te kufizuar pas likuidimit te taksave dhe te shpenzimeve te tjera qe ka kjo shoqeri, do t'i nenshtrohet ndarjes sipas kapitaleve te vena.

### NENI 11

Çmimet e shitjes se produkteve dhe te artikujve te ndryshem te konsumit te gjere te kesaj shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, normalisht do te caktohen nga vete shoqeria tregtare ne baze te kerkeses dhe ofertes.

### NENI 12

Organizimi dhe drejtimi i shoqerise tregtare do te behet ne baze te statutit.

### NENI 13

Te gjitha mosmarreshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptimin e paleve kontraktuese, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.



**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMERTIMIN**  
**"ALUMIL-ALBANIA" SH.P.K.**

NENI 1

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "ALUMIL-ALBANIA" SH.P.K me ortake themelues:

1. Shoqeria Anonime "ALUMIL - MYLONAS, ALUMINIUM EXTRUSION INDUSTRY A.E." me seli ne Zona Industriale Stavrohorio Kilkis- Greqi, e perfaqesuar nga Z.Georgios Mylonas.
2. Georgios MYLONAS, i biri i Aleksandrit, lindur ne vitin 1959 ne Dhomiros Seron - Greqi, me numer M - 986704 te pasaportes greke dhe banues ne Rr. Pythagora Nr.23, Panorama - Selanik, Greqi;
3. Evangelia MYLONA, e bija e Aleksandrit e lindur ne vitin 1964 ne Serres - Greqi, me numer te pasaportes greke M - 179605 dhe banuese ne Rr. Vryoylon Nr.1, Kallamaria, Selanik- Greqi;
4. Panajot KALLUDHI, i biri i Nikolles, i datelindjes 1956, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, Rruga Budi Nr.43 me Nr. pasaporte 0250328.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne Qytetin e Tiranes, ne adresen: Rruga e Durresit, Nr.60. Shoqeria mund te hape dege e agjenci ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jashte shtetit me miratim te organeve kompetente.

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete e pacaktuar.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete:

- Tregeti e pergjithshme Import-Eksport.
- Ndertimi i nje Fabrike Alumini, importim, prodhim dhe tregtim i profileve te aluminit, aksesoreve te aluminit, shkrirje, derdhje alumini, lyerje profilesh alumini.
- Import-Eksport dhe tregtim skrap i aluminit.
- Import-Eksport dhe tregtim i cdo materiali ndertimi si dhe malli me kete prejardhje, si dhe kryerja e sherbimeve.
- Shoqeria gjithashtu ne veprimtarine e saj kryesore dhe ndihmese do te kryeje dhe aktivite te tjera qe lidhen me objektin kryesor te veprimtarise se shoqerise dhe qe duhet te jene ne perputhshmeri me interesat e saj.

## NENI 5

Kapitali i themeltar i Shoqerise caktohet ne 120.000 (njeqind e njezet mije) Dollar USA. Kapitali i mesperm ndahet ne dyqint pjese, me vlere 600 Dollar USA secila.

Konkretisht, Kapitali themeltar i depozituar nga ortaket themelues eshte i ndare:

- Shoqeria Anonime "ALUMIL-MYLONAS, ALUMINIUM EXTRUSION INDUSTRY A.E." ne Kilkis-Greqi ne shumen 112.800 Dollar USA, me 188 pjese te kapitalit themeltar, baraz me 94%.
- Georgios Mylonas me shumen 2.400 Dollar USA, ne 4 pjese, baraz me 2% te kapitalit themeltar.
- Evangelia Mylona me shumen 2.400 Dollar USA, ne 4 pjese, baraz me 2% te kapitalit themeltar.
- Panajot Kalludhi me shumen 2.400 Dollar USA, ne 4 pjese, baraz me 2% te kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund te shtohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Çdo ndryshim i kapitalit themeltar pasqyrohet ne librin e shoqerise, ne te cilin regjistrohen emrat e ortakeve dhe kontributi i tyre.

## NENI 6

Ortaku qe deshiron te transferoje pjeset e tij eshte i detyruar te njoftoje ortaket e tjere per ushtrimin e te drejtes se parablerjes. Ortaket jane te detyruar t'i pergjigjen ofertes se ortakut brenda dhjete diteve nga data e marrjes se komunikimit. Ne rast se shumica e ortakeve pranon blerjen e pjeseve, atehere i blejne keto dhe i ndajne proporcionalisht.

Ne rast mosmarreveshjeje persa i takon vleres se pjeseve qe ofrohen per shitje, atehere caktohet nje ekspert kontabel per vleresimin e tyre.

Ne rast se eshte e pamundur te caktohet ekspert brenda dhjete diteve, emerimi i tij behet nga gjykata.

Ne rast se ortaket qe ftohen per blerje tregohen indiferente ose nuk pranojne ne menyre kategorike te ushtrojne te drejten e parablerjes, ortaku shites ka te drejte te kerkoje persona te trete. Ne kete rast ndalohet shitja tek me shume se nje person, me qellim qe te mos prishet ekuilibri i krijimit te shumices ne Asamblene e ortakeve.

Kalimi i pjeseve kryhet gjithmone me akt noterial.

Ne menyre kategorike, permendet dhe rekomandohet baze ligjore te kontrates se themelimit dhe te Statutit, qe ortaku Shoqeria Anonime "ALUMIL-MYLONAS, ALUMINIUM EXTRUSION INDUSTRY A.E." e perfaqesuar nga Georgios Mylonas autorizohet te transferoje lirshem pjese te saja tek persona te trete pa kerkuar nga ortaket te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes ose miratimit te trashegimtareve te saja. Kete te drejte mund te ushtroje vete ajo, apo ne rruge trashigimore ne cdo kohe, pa asnje kundershtrim nga ortaket e tjere te saj. E njejta e drejte i takon edhe atij trashegimtari, ne rast se ortaku Shoqeria Anonime "ALUMIL-MILONAS, ALUMINIUM EXTRUSION INDUSTRY A.E." ben kalimin e te gjitha pjeseve te tij dhe largohet nga shoqeria.

Ne rast vdekjeje te ndonjerit prej ortakeve, trashegimtaret e tij te ligjeshem trashegojne te drejatat dhe pjeset e tij.

## NENI 7

Personi juridik mban librin e ortakeve me te gjitha te dhenat si: emri, mbiemri, atsia, datelindja, vendlindja, shtetesia, adresa e banimit apo e selise. Ne kete liber regjistrohen kontributet ne kapitalin themeltar, pjeset e secilit ortak dhe ndryshimet e mundeshme.

Konsiderohen ortake dhe mund te ushtrojne te drejatat e tyre para organeve te shoqerise, te gjitha ata persona qe jane regjistruar ne librin e shoqerise.

## NENI 8

Organet e shoqerise jane Asambleja e Ortakeve dhe Administratori.

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise dhe vendos per çdo çeshtje qe ka lidhje me shoqerine. Ajo vendos per ndryshimet ne statut, per emerimin dhe shkarkimin e administratorit, per pranimin e ortakeve te rinj, per shtimin e kapitalit themeltar, per miratimin e bilancit vjetor, per ndarjen e fitimeve, per padi kundrejt perfaqesuesve te shoqerise, per shkrijen e personit juridik dhe ne pergithesi perben vullnetin e shoqerise pa asnje kufizim, brenda kushteve te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Asambleja e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit dhe bile gjate tremujorit te pare nga data e perfundimit te vitit ekonomik. Thirrja per kete mbledhje behet me shkrim, te pakten pesembjedhete dite me perpara.

Asambleja e jashtezakonshme thirret nga administratori ose nga ortaket qe perfaqesojne 20% e lart te kapitalit themeltar te shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte e vlefshme ne rast se marrin pjese ortaket qe perbejne me teper se 1/2 te kapitalit themeltar. Vendimet e asamblese merren me shumice votash te pjeseve te kapitalit qe marrin pjese ne mbledhje. Nje pjese te kapitalit i takon e drejta e nje vote.

Per ndryshime ne statut kerkohet miratimi i ortakeve qe perfaqesojne 3/4 pjese te kapitalit themeltar .

Ne çdo mbledhje te Asamblese se Ortakeve mbahet proces-verbal, i cili firmoset nga ortaket qe marrin pjese ne mbledhje.

## NENI 9

Shoqeria drejtohet, gjate aktivitetit te saj, nga administratori. Administrator i shoqerise caktohet Georgios Mylonas. Ai drejton dhe administron çeshtjet e perditeshme te shoqerise , ne baze te ligjit, te statutit dhe udhezimeve te asamblese se ortakeve,

perfaqeson personin juridik dhe vepron ne emer dhe per llogari te tij per arritjen e qellimit te shoqerise. Ne veçanti, perfaqeson shoqerine dhe e angazhon ate para organeve shtetere dhe private, personave fizike e juridike, duke firmosur poshte emertimit te shoqerise. Administratorin mund ta shkarkoje asambleja e ortakeve. Administratori eshte i detyruar te kujdeset dhe te mbaje librat e shoqerise, te perballoje dhe te likujdoje ne kohe detyrimet ndaj te treteve ose te vjele detyrimet e shoqerise. Administratori perfaqeson shoqerine para organeve gjyqesore, organeve administrative te shtetit, para çdo personi juridik apo fizik, terheq kredi nga bankat apo institucione te tjera kredidhenese, cakton avokate te tjere autorizues, merr ne pune personelin per shoqerine dhe cakton rrogat dhe marredheniet e punes.

Administratori Georgios Mylonas cakton si perfaqesues te tij per te kryer te gjitha detyrat e tij Zotin Sotirios Athanas Boulios.

## NENI 10

Ne rast nevojje te kontrollit te shoqerise, ai kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per nje vit financiar me mundesi ri zgjedhjeje nga shumica e ortakeve qe perfaqeson mbi 1/2 e kapitalit themeltar. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pa mundur kryerja e detyres

## NENI 11

Ne fund te çdo viti financiar dhe nen kujdesin dhe pergjegjesine e administratorit, kryhet perpilimi i te gjitha te dhenave te aktivitetit dhe te pasivitetit me pershkrim te hollesishem per gjithe aktivitetin e kesaj shoqerije. Mbi kete baze, nga administratori dhe sektori i finances perpilohet bilanci me analize te hollesishme te llogarise humbje-fitime.

Viti financiar fillon ne 1 Janar te cdo viti kalendarik dhe perfundon me 31 Dhjetor. Brenda tremujorit te pare, pas perfundimit te viti financiar perpilohet bilanci i cili duhet te miratohet nga

Asambleja Ortakeve. Fitimet e realizuara ndahen midis ortakeve ne raport me kontributin e tyre ne kapitalin e shoqerise.

#### NENI 12

Pas miratimit te llogarise vjetore dhe te evidentimit te egzistences se fitimeve, Asambleja e Ortakeve percakton pjesen qe ju takon ortakeve ne formen e dividendeve mbi fitimin. Fitimi qe do te ndahet ndermjet ortakeve, ne perpjesim me pjeset ne kapitalin themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjeane per fondin rezerve te domosdoshem (5% e fitimit te cdo viti, deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 te kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetere, i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme.

#### NENI 13

Shoqeria shkrihet ose me vendim te Asamblese se Ortakeve ose ne baze te ligjit. Ne rast shkrijeje te shoqerise do te ndiqet procedura e likuidimit te saj ne baze te dispozitave ligjore. Asambleja e Ortakeve cakton likuiduesit.

Gjate periudhes qe shoqeria eshte ne likuidim ne emertmin e saj shtohet fjala "Ne likuidim".

#### NENI 14

Ne rast mosmarreshjeje, kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen me rruge gjyqesore nga Gjykata e Rrethit Tirane.

#### NENI 15

Ky statut u perpilua ne kater egzemplare origjinale, i cili pasi u lexua nga ortaket pjesmarres u nenshkrua rregullisht perj tyre ne prani te noterit.

#### ORTAKET THEMELUES

1. Shoqeria Anonime "ALUMIL-MYLONAS" (ALUMINIUM EXTRUSION INDUSTRY A.E.) (perfaqesuar nga Georgios MYLONAS)
2. (Georgios MYLONAS)
3. (Evangelia MYLONA)
4. (Panajot KALLUDHI)

Tirane, me 11 Qershor 1998

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr. 3128 Rep. Nr. 410 kol.

#### VERTETIM

Sot me date 11 qershor 1998 para meje Noteres u paraqiten ortaket: Shoqeria Anonime "ALUMIL-MYLONAS, ALUMINIUM EXTRUSION INDUSTRY A.E." e parfaqesuar nga Georgios Mylonas, i biri i Aleksandrit, i datelindjes 1959, banues ne Rr.Pythagora Nr.23, Panorama-Selanik,Greqi, me numer te pasaportes greke M-986704; ortaku Georgios Mylonas me te njejtin identitet si me sipër; ortakja Evangelia Mylona, e bija e Aleksandrit, e datelindje 1964, banuese ne Rr. Vryoylon Nr.1 Kallamaria-Selanik,Greqi, me numer te pasaportes greke M-179605;ortaku Panajot Kalludhi, i biri i Nikolles, i datelindjes 1956, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, ne Rrugen Budi,Nr.43 me numer te pasaportes 0250328, te pa njohur prej meje per identitetin e te cileve u njoha nga Leter njoffimet e tyre personale, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se Statuti dhe Akti i Themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ALUMIL-ALBANIA" SH.P.K. Tirane, shpreh vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe si te tille e nenshkruajne para meje Noteres.

